

Njoftim për botimin e ardhshëm të Revistës "Profesionistët e Shëndetit"

Këshilli i Redaksisë së Revistës "Profesionistët e Shëndetit" njofton autorët dhe kontribuesit për botimin e ardhshëm të revistës sonë. Autorët inkurajohen të paraqesin punimet e tyre duke u bazuar në udhëzimet e paraqitura në faqen tonë zyrtare të internetit. Data e fundit për paraqitjen e punimeve është 31.07.2024.

Ju lutemi të kontaktoni redaksinë në adresën e emailit uishrevista@gmail.com nëse keni ndonjë pyetje apo nevojë për informacion shtesë.

Të vazhdojmë të ndajmë njohuri dhe të përcjellim ndryshime në fushën e shëndetit!

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

LLOJET E ARTIKUJVE

Llojet e artikujve shkencore për botim përfshijnë:

1. **Artikuj Original Kërkimore:** Këta artikuj prezantojnë rezultatet e studimeve të reja të kryera nga autorët. Përmbajtja e tyre përfshinë hipotezat, metodologjinë, rezultatet dhe diskutimet e gjetjeve.
2. **Artikuj Review literature (Review Articles):** Këta artikuj ofrojnë një sintezë të literaturës ekzistuese në një fushë të caktuar të studimit. Ato mund të shqyrtojnë progresin e fundit në trajtimin e një sëmundjeje, rritet në fushën e kërkimit shkencor dhe të ofrojnë interpretime të reja ose analiza.
3. **Artikuj Shkencor Eksperimental:** Këta artikuj përmbajnë rezultate nga eksperimente të planifikuara dhe të zbatuara në laborator ose në terren. Përmbajtja e tyre përfshin planifikimin e eksperimentit, metodologjinë, rezultatet dhe interpretimin e tyre.
4. **Artikuj të Rasteve Klinike:** Këta artikuj përmbajnë informacion mbi rastet klinike, trajtimet, dhe rezultatet e tyre. Përmbajtja e tyre përfshinë historinë e pacientit, metodat e trajtimit, dhe vlerësimin e rezultateve.
5. **Artikuj Meta-Analitike:** Këto janë artikujt meta-analitikë, të cilët kombinojnë dhe analizojnë rezultatet e studimeve të pavarura për të arritur në përfundime më të besueshme rreth një teme të caktuar. Ata ofrojnë një analizë të thellë të rezultateve të shumta të studimeve dhe vlerësimit të përbashkët të gjetjeve, duke sjellë një perspektivë të plotë dhe të përafërt në fushën e kërkimit shkencor.
6. **Artikuj Shkencorë Teorike:** Këta artikuj ofrojnë zhvillime teorike të reja ose aplikime të teorive ekzistuese në një fushë të caktuar të studimit.

Këto janë disa prej llojeve me të zakonshme të artikujve shkencorë të cilët shqyrtohen për tu botuar në revisten shkencore “Profesionistët e Shëndetit”. Pavarësisht nga llojet e artikujve të përmendur më sipër, mund të ketë edhe lloje të tjera të artikujve që mund ti dergoni për publikim.

Në qoftë se keni ndonjë pyetje shtesë, jeni të lutur të kontaktoni redaksinë në adresën e emailit uishrevista@gmail.com

MODEL

TITULLI I ARTIKULLIT

Emër Mbiemër ¹ Emër Mbiemër ² Emër Mbiemër ³ etj...

¹ Adresën përkatëse profesionale, ² Adresën përkatëse profesionale, ³ Adresën përkatëse profesionale

Email: medical@gmail.com

Abstrakt. (maksimumi 300 fjalë)

Hyrje Qëllimi. Metodologjia. Rezultatet. Konkluzione.

Fjalë kyçe: (deri në 5-6 fjalë)

ARTIKULLI (deri në 6 faqe)

- **Hyrje** (rishikim i literaturës dhe të dhëna)
- **Metodologjia e studimit**
- **Rezultatet e studimit tuaj**
- **Diskutimet**
- **Konkluzionet e dala prej studimit**
- **Biografi e shkurtër 2-3 rreshta.**
- **Foto**

Foto profili
profesionale

- **Lista e referencave/Bibliografia**¹

¹Cattaruzzi C, Cadelli L, Marcuzzo L, Antonini A, Groppo B, Ros B, Tosolini M, Lemessi N. Feasibility of a multidisciplinary approach for medical review among elderly patients in four Italian long-term nursing homes. Eur J Hosp Pharm. 2018 Jul;25(4):207-209. doi: 10.1136/ejhpharm-2015-000812. Epub 2016 May 24. PMID: 31157021; PMCID: PMC6452356.

Artikulli duhet të dërgohet në adresën e emailit të Revistës së UISH-së

uishrevista@gmail.com

uish_albania@yahoo.com, të emërtuar **emër, mbiemër-titulli i artikullit**